



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV  
TIRANE

NR. 9939/5299/2955 AKTI

NR. 3407 VENDIMI

VENDIM  
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Apelit Administrativ, ne trup gjykues te perbere nga:

**ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA)----Gjyqtare;**  
**ARJAN QAFI-----Gjyqtar;**  
**ALKELINA GAZIDEDJA-----Gjyqtare;**

Asistuar prej sekretares [REDACTED], sot më dt.25/10/2016, pasi mori për shqyrtim ne dhomë këshillimi cështjen administrative me nr. 9939/5299/2955 Akti, me palë:

**PADITES:** Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë.

**I PADITUR:** Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Tiranë me adresë Rr."Sami Frashëri", nr.10, Tiranë, përfaqësuar nga [REDACTED] dhe [REDACTED] me autorizim.

Avokatura e Shtetit ka deleguar të drejtën e përfaqësimit organit administrativ.

**OBJEKTI:** Anullim i vendimit nr. 54, datë 17.04.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 115 e vijues të K.Pr.Administrative, Kodi i Punës, Ligji Nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Se me vendimin nr. 5178, datë 29.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur:

- Referuar vendimit nr.54 date 17.4.2014 te Komisionerit i cili ka dale ne konkluzionin se per shkak te shoqerimit qe znj. [REDAKTUAR] shoqeronte te birin ne spital si rezultat i mungeses se saj gjate orarit te punes i jane nderprerë marredheniet e punes per shoqerimin qe i bente te birin ne spital duke ju referuar nenit 3, pika 4 te ligjit nr.10.221 date 4.2.2010, ky fak qe i referohet Komisioneri nuk eshte i vertete, shkak i largimit te saj nga puna jane masat disiplinore qe kerkuesja ka marre.

### GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV

pasi degjoi relatimin e çeshtjes nga gjyqtari kryesues, referuar akteve bashkengjitur dosjes Nr. 9939/5299/2955, Dt.21.11.2014:

#### VEREN

Se Vendimi Nr. 5178 datë 29.09.2014 i Gjykates Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është rrjedhojë e zbatimit të ligjit e material e procedural e duhet të mbetet në fuqi.

Nga provat e administruara ka rezultuar se, pala paditese Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë ka qenë me cilësinë e punëdhënësit me shtetasen znj. [REDAKTUAR] te cilen e ka pushuar nga puna me arsyetimin e mosrespektimit te disipline ne pune.

Shtetësja [REDAKTUAR] ka paraqitur nje ankim tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Tiranë, i cili pasi ka shqyrtuar procedurën e largimit të saj nga puna dhe ka konstatuar diskriminim dhe ka rekomanduar qe pala punedhenese qe eshte institucion shteteror të riktheje shtetasen [REDAKTUAR] ne punen e meparshme.

Pas vënies në dijeni të rekomandimit të sipërcituar, pala paditëse në këtë gjykim rezulton t'i jetë drejtuar secila prej tyre me kërkesë – padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kërkuar sipas objektit të padisë.

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, pala paditëse ka pretenduar te njejtat fakte te konfirmuara edhe ne ankimin ndaj vendimit te gjykates se shkalles se pare, pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, pala e paditur ka prapësuar se:

Gjate inspektimit te zhvilluar me date 04.11.2013, ne kuader te shqyrtimit te ankeses nr. 38 rregj., date 31.07.2013 te znj. [REDAKTUAR], ne Drejtorine e Konvikteve te Shkollave te Mesme, z. [REDAKTUAR] ka informuar grupin e inspektimit si

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 5178 datë 29.09.2014 ka vendosur "Rrëzimin e padisë", sipas disponimeve të pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duke argumentuar ndër të tjera se:

*"Se pari; vertetohet se ankuesja [REDAKTUAR], ka djalin e saj [REDAKTUAR] invalid të grupit të parë, dhe nga komisioni është caktuar si person pergjegjes që perkujdeset për personin e paafte. Referuar ligjit për sigurimet shoqërore personat që përkujdesen për persona të paafte kanë të drejtë për punë me orare të reduktuara.*

*Se dyti; nga pala punedhenese/ paditese ky fakt ka qenë i njohur pavarësisht prapësimit në kërkesëpadi. Ky fakt është pranuar nga vete drejtuesi i paditesit në takimet e zhvilluara me inspektore të komisionerit, dokumentuar ky pohim nga procesverbali i takimeve.*

*Së treti; nga ana e komisionerit është respektuar ligji i posacem 10221/2010 si dhe K.Pr.administrative kur ka zhvilluar një procedurë hetimore në respekt të parimeve të njohura të procesit të drejtë ligjor, duke krijuar palet paditese mundësi për tu njohur me aktet e perdorura në procedim, për të parashtruar argumentat e tij dhe se fundi vendimi përbyllje të procedurës është i arsyetuar dhe i është komunikuar rregullisht paditesit.*

*Se fundi, referuar akteve shkresore rezultoi e provuar se paditesi ka qenë në dijeni të rrethanave familjare të shtetasës [REDAKTUAR] dhe pavarësisht detyrimeve ligjore dhe humane, nuk i ka krijuar ankueses aksesin e nevojshëm për të ushtruar pergjegjesitë prinderore. Pretendimi i perdorur në gjykim nga pala paditese se kishte krijuar kushte të barabarta për të gjithë punonjësit, është treguesi me i qartë i diskriminimit pasi nuk mund të jenë në kushte të barabarta punë persona që objektivisht janë në kushte të pabarabarta. Në rastin konkret paditesja për shkak të semundjes së rëndë të të birit nuk mund të trajtohej sikundër punonjësit e tjerë aq më tepër në rrethanat kur nga ana e KMCAP ishte caktuar si person pergjegjes për personin e paafte.*

*Nga ana tjetër nga pala paditese nuk u pretendua dhe as konstatohet se është në pamundësi objektive për të përmbushur rekomandimet e komisionerit kundër diskriminimit, rekomandime të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar për subjektet që i drejtohet, e për pasoje padia duhet rrezuar si e pabazuar në ligj e në prova".*

### **Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit**

Ky kolegji vlerëson se në analizë të provave, shpjegimeve të palëve, shkaqeve të ngritura në ankim nga pala e paditese dhe ligjit të aplikueshëm në rastin konkret, çmon se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

*pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”*

*Neni 33, pika 11 parashikon se “ Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal...*

*Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”.*

Ka rezultuar se provuar nga aktet e dosjes se, pala paditese Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë ka qenë me cilësinë e punëdhënësit me shtetasen znj. [REDAKTUAR] te cilën e ka pushuar nga puna me arsyetimin e mosrespektimit të disziplines në punë.

Shtetësja [REDAKTUAR] ka paraqitur një ankim tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Tiranë, i cili pasi ka shqyrtuar procedurën e largimit të saj nga puna dhe ka konstatuar diskriminim shtetasen [REDAKTUAR].

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Tiranë me vendimin nr.54, dt.17/04/2014 ka vendosur “ Konstatimin e drejtëpërdrejtë, për shkak të dhovqërimit të shtetasës [REDAKTUAR] nga Drejtori i Konvikteve të Shkollave të Mesme [REDAKTUAR] dukle e vënë atë në kushte jot ë favorshme , në raport me punonjësit e tjerë të Konvikteve të Shkollave të Mesme. Rekomandimin për Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme që të rikthejë në pozicionin e mëparëshëm të punës shtetasen [REDAKTUAR] Etj...

Ky kolegji cmon se ky akt administrative vendimi nr.54, dt.17/04/2014 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Tiranë është një akt administrativ i nxjerrë conform ligjit 10221, dt.04/02/2011 “ Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, e në përputhje me K.Pr.Administrative.

Se pari; vertetohet se shtetasja ( ankues) [REDAKTUAR] ankues, ka djalin e saj [REDAKTUAR] invalid të grupit të parë, dhe nga komisioni është caktuar si person përgjegjes

## VENDOSI

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 5178, datë 29.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit së këtij vendimi.
- U shpall sot 25/10/2016 në Tiranë.

<b>GJYQTAR</b>	<b>GJYQTARE</b>	<b>GJYQTARE</b>
<b>ARJAN QAFI</b>	<b>ALKELINA GAZIDEDJA</b>	<b>ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA)</b>
<b>DV</b>	<b>DV</b>	<b>DV</b>
<b>E NJEHSUAR ME ORIGJINALIN</b>		

